



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	06	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No.	05-8795
Nr. i faqave Br. stranica No. pages	- 38 -	Data: Datum: Date:	24/12/2020
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Departamenti për zhvillim strategjik shëndetësor / Departman za strateški razvoj zdravstva /
Department of Strategic Development in Health

PËR/ZA/TO:	Z. Armend Zemaj / Ministër i Shëndetësisë				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Ardian Mehmetaj / Ud Sekretari i Përgjithshëm				
NGA/OD/FROM:	Dr. Valdet Hashani / Ud udhëheqës i Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor				
CC:	Z. Besnik Stuja / Zyrtar përgjegjës për hartim të planit të veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID 19 2020-2021				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për miratim të planit të veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID 19 2020-2021				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	109	Lokacioni: Kucni: Extension:	MSh	Data: Datum: Date:	22/12/2020
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar Z. Ministër,

Grupi punues ka finalizuar hartimin e Planit të veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID 19 2020-2021.

Ky Plan është hartuar në pajtim me Planin e Reagimit Kombëtar FM8, Ligjin për Shëndetësi Nr 05/L-125, Ligjin për Shëndet Mendor Nr 05/L-025, praktikat dhe përvojat e vendeve të ndryshme të Europës dhe botës si dhe dokumentet e organizatave relevante ndërkombëtare në ballafaqim me Pandeminë COVID 19.

Të bashkëngjitur gjeni:

1. Formularin e vlerësimit të ndikimit buxhetor
2. Planin e veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID 19 2020-2021

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

**PLANI I VEPRIMIT PËR SHËNDET MENDOR
GJATË DHE PAS PANDEMISË COVID 19
2020-2021**

DHJETOR 2020

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Hyrje
3. Metodologjia
4. Sfondi
5. Objektivat
6. Aranzhimet e zbatimit, monitorimitdheraportimit
7. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i planit të veprimit
8. Referencat
9. Plani i veprimit

Shkurtesat

APK	Asociacioni i Psikiatërve të Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPF	Instituti i Psikiatrisë Forenzike
KPSH	Kujdesi parësor shëndetësor
KDSH	Kujdesi dytësor shëndetësor
KTSH	Kujdesi tretësor shëndetësor
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QIRSKP	Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurve Kronik Psikiatrik në Shtime
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QSK	Qendra Studentore Karantinë
QSHM	Qendra e Shëndetit mendor
OMK	Oda e Mjekëve të Kosovës
SHIB	Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
SP	Spital i përgjithshëm

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë Covid 19 për vitet 2020-2021 është hartuar në pajtim me Planin e Reagimit Kombëtar FM8, Ligjit për Shëndetësi Nr 05/L-125, Ligjit për Shëndet Mendor Nr 05/L-025, praktikat dhe përvojat e vendeve të ndryshme të Europës dhe botës si dhe organizatave relevante ndërkombëtare në ballafaqim me pandeminë Covid 19.

Plani i veprimit, bazë ka parimin e qasjes së barabartë dhe gjithëpërfshirës për qytetarët në nevojë për shërbime dhe kujdes të shëndetit mendor. Plani në vete ngërthen objektiven e përgjithshme dhe ato specifike që adresojnë nevojat e popullatës duke përfshirë edukimin, promovimin, parandalimin, trajtimin, dhe bashkëpunimin ndërinstytucional përmes promovimit të shërbimeve inovative të shëndetit mendor, udhëzuesve për trajtim, udhëzuesve edukativ, materialeve tjera të shkruara dhe elektronike në shërbim të popullatës së gjërë përfshirë hulumtimet në terren dhe monitorimin, duke përshtatur ofrimin e shërbimeve dhe kujdesit për shëndet mendor dhe mbështetjen psikosociale me kapacitetet e sistemit shëndetësor publik në vend dhe situatën e re të krijuar si pasojë e pandemisë me Covid 19.

Bazuar në të dhënat e siguruara, të bazuara në dëshmi nga raportet dhe hulumtimet në dispozicion, janë identifikuar sfidat të cilat duhet adresuar me qëllim të ruajtjes së shëndetit mendor të popullatës gjatë dhe pas pandemisë me Covid 19. Adresimi i këtyre sfidave është bërë përmes definimit të objektivave dhe aktiviteteve specifike, realizimi i të cilave do të ndikoj në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të ofruara që kanë për qëllim ruajtjen e shëndetit mendor të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Monitorimi i zbatimit të dokumentit do të bëhet përmes indikatorëve të përcaktuar, nga ana e Komitetit të Shëndetit Mendor i cili bazuar në mandatin e tij do të përgatis raporte të rregullta të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve në MSh.

2. HYRJE

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka shpallur shpërthimin e Covid 19 si emergjencë shëndetësore në nivel ndërkombëtar me mundësinë e lartë të përhapjes në të gjitha vendet e botës, ndërsa në Mars të vitit 2020 OBSH-ja vlerësoi se Covid 19 mund të kategorizohet si sëmundje pandemike¹.

Ndikimet e para të pandemisë u vërejtën edhe në shëndetin mendor në shumë vende të botës. Bazuar në të dhënat nga OBSH-ja dhe shumë organizata tjera ndërkombëtare të cilat rekomanduan hartimin eudhëzuesve dhe planeve të veprimit për kujdes të popullatës në fushën e shëndetit mendor².

Bazuar në të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) dhe MSh në Republikën e Kosovës rasti i parë me infeksionin SARS-Cov 2 u regjistrua me 13 mars 2020 dhe me qëllim të parandalimit dhe përhapjes së infeksionit edhe Kosova u detyrua të vendos masa kufizuese. MSh duke u bazuar në vlerësimet e gjendjes së shëndetit mendor në situatë pandemie dhe duke parë ndikimet e saj, inicoi hartimin e Planit të veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID-19 (Plani e veprimit) me qëllim që me prioritet t'i përgjigjet nevojave të qytetarëve për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor.

2.1 Gjendja e shëndetit mendor të popullatës në botë dhe Kosovë gjatë pandemisë COVID 19

Sipas OBSH, izolimi shoqëror, frika nga infektimi, humbja e anëtarëve të familjes, shqetësimi nga humbja e të mirave materiale, humbja e punësimit dhe shqetësimet për të ardhmen, tregojnë se pandemia Covid 19 si asnjëherë më parë ka prodhuar efekte me përmasa shqetësuese në gjitha sferat e jetës pa e amnestuar shëndetin mendor të popullatës e veçanërisht grupet e rrezikut si fëmijët, adoleshentët, të moshuarit, personat me çrregullime të rënda të shëndetit mendor, personat e predispozuar për çrregullime të shëndetit mendor, gratë dhe natyrisht profesionistët shëndetësorë të cilët janë linja e parë e ballafaqimit me qytetarët e prekur nga infeksioni me Covid 19 në gjithë botën. Ngjarja e këtillë e papritur ka shkaktuar çrregullime të ndryshme të shëndetit mendor përfshirë stresin, ankthin, depresionin, dhunën, abuzimin me substanca, stigmatizimin, çrregullime të sjelljes si dhe çrregullime të tjera psikologjike, psikiatrike e psikosomatike. Më shumë se një e treta e amerikanëve (36%) në një anketë të Asociacionit Amerikan të Psikiatërve thonë se koronavirusi ka një ndikim serioz në shëndetin e tyre mendor³.

¹WHO, mental health and psychological consideration during the Covid-19 outbreak. ÈHO.2020 (ÈHO reference number: WHO/2019-nCov/Mental Health/2020.1).

²https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_briefcovid_and_mental_health_final.pdf

³<https://www.psychiatry.org/newsroom/news-releases/neë-poll-covid-19-impacting-mental-ëell-being-americans-feeling-anxious-especially-for-loved-ones-older-adults-are-less-anxious>

Në Kinë, 14.592 persona të anketuar në popullatën e përgjithshme të cilët u vlerësuan për statusin psikologjik në internet me PHQ-9 dhe GAD-7, rezultuan me depresion 53.5% dhe ankth 44.6%⁴. Në Britani të Madhe raportohen gjetjet fillestare në 2,025 pjesëmarrës në një hulumtim në internet duke përdorur PHQ-9 me shkallë të depresionit 22,12% dhe duke përdorur GAD-7 shkallë të ankthit 21.63%⁵.

Prindërit në Itali dhe Spanjë kanë raportuar se te fëmijët e tyre kanë vërejtur vështirësi në përqëndrim, shqetësim e nervozizëm, veçanërisht gjatë kohës së masave të mbylljes, poashtu fëmijët kanë përjetuar dhunë dhe abuzim ose kanë qenë dëshmitarë të tyre.

Gratë, personat e moshuar dhe njerëzit me predispozita për çrregullime të shëndetit mendor, përfshirë dhe përdoruesit e drogave, përdoruesit dhe abuzuesit me alkool mbetën shqetësimi i profesionistëve të shëndetit mendor. Në Kanada është raportuar për rritje 20% të konsumit të alkoolit në moshat 15-49 vjeçe.

Profesionistët shëndetësorë në linjen e parë të shërbimit janë ballafaquar me mbingarkesë në punë, vendime të vështira për trajtim të pacientëve në situata të rënda, rrezikun nga infektimi që tani janë të dëshmuara me studimet e realizuara në Kinë ku profesionistët shëndetësorë kane raportuar nivel të lartë të depresionit (50%), ankthit (45%) dhe pagjumësisë (34%)⁶.

Ndërprerja apo dhe pezullimi i ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor në shumë vende ka ndikuar në rritje të numrit të qytetarëve që kanë nevojë për këto shërbime, veçanërisht nevoja për shërbime ballë për ballë, grupet vetë ndihmëse për alkoolin e drogën, dhe shërbimet komunitare si qëndrimi ditor i klientëve, gjë që ka ndikuar nëpër keqësimin e gjendjes së tyre të shëndetit mendor.

Bazuar në faktet e mësipërme është e qartë se shëndeti mendor duhet të trajtohet me prioritet dhe mbetet përgjegjësi kolektive e Qeverisë dhe shoqërisë civile për t'iu përgjigj nevojave të qytetarëve me qëllim që të ruhet dhe arrihet përmirësimi i shëndetit mendor shkaktuar nga pandemia Covid 19, në të kundërtën dështimi për ta marr me seriozitet mirëqenien mendore dhe ruajtjen e shëndetit mendor të popullatës, qeverive do t'iu shkaktoj pasoja afat gjate ekonomike dhe shoqërore.

⁴Liu D, Ren Y, Yan F, Li Y, Xu X, Yu X, Qu E, Eang Z, Tian B, Yang F, Yao Y. Psychological Impact and Predisposing Factors of the Coronavirus Disease 2019 (COVID-19) Pandemic on General Public in China. (3/7/2020). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=3551415> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3551415>

⁵Shevlin, et al 2020, (4) Shevlin M, McBride O, Murphy J, Miller JG, Hartman TK, Levita L, Mason L, Martinez AP, McKay R, Stocks TV, Bennett KM. Anxiety, Depression, Traumatic Stress, and COVID-19 Related Anxiety in the UK General Population During the COVID-19 Pandemic

⁶Kang L, Li Y, Hu S, Chen M, Yang C, Yang BX. et al. The mental health of medical workers in Wuhan, China dealing with the 2019 novel coronavirus. Lancet Psychiatry. 2020 doi.org/10.1016/S2215-0366(20)30047-X

3. METODOLOGJIA

Plani i veprimit për shëndet mendor gjatë dhe pas Pandemisë Covid 19 për vitet 2020-2021 është hartuar në pajtim me Planin e Reagimit Kombëtar FM8, Ligjin për Shëndetësi Nr 05/L-125, Ligjin për Shëndet Mendor Nr 05/L-025, praktikat dhe përvojat e vendeve të ndryshme të Europës dhe botës, dhe dokumentet e organizatave relevante ndërkombëtare në ballafaqim me Pandeminë Covid 19.

Grupi punues ka analizuar dokumentet relevante të publikuara nga OBSH, UNICEF dhe burime tjera të informatave të bazuara në dëshmi. Gjithashtu janë shfrytëzuar edhe hulumtimet e realizuara nga profesionistët dhe hulumtuesit vendor gjatë kohës së Pandemisë në Kosovë.

Dokumenti është hartuar nga grupi punues multidisiplinar i cili gjatë fazës së hartimit është konsultuar edhe me profesionistë tjerë relevantë të lëmive përkatëse por dhe ka siguruar të dhëna nga institucionet shëndetësore respektive.

Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të këtij plani, do të shfrytëzohen për procesin e rishikimit të tij.

Duke pasur parasysh specifikat e realitetit Kosovar dhe ekspertizën relevante ndërkombëtare, zhvillimi i shërbimeve të shkallëzuara të kujdesit për shëndetin mendor në periudhën e Pandemisë Covid 19 (stepped care model) paraqet zgjidhjen më optimale për modelin e shërbimeve që duhet të zhvillohen për ballafaqimin me këtë sfidë globale në vendin tonë.

Plani i veprimit është plan një vjeçar dhe përfshin periudhën 2020-2021.

4. SFONDI

Sikurse edhe në vendet e tjera masat kufizuese të ndërmarra nga Qeveritë për parandalimin dhe përhapjen e infeksionit me Covid 19 si izolimi shoqëror, mungesa e lëvizjes së lirë, karantinimi, mbyllja e shkollave, universiteteve, bizneseve, aktiviteteve sportive e shoqërore, Institucioneve fetare, dhe humbja e vendeve të punës, ka rritur shqetësimet, ankthin, depresionin në të gjithë popullatën duke përfshirë dhe grupet me rrezik si fëmijët, adoleshentët, të moshuarit, gratë dhe personat që kanë predispozita për çrregullime të shëndetit mendor.

MSh dhe Departamenti i Psikologjisë i Universitetit Hasan Prishtina kanë ofruar shërbime të ndihmës së parë psikologjike përmes telefonit dhe chatit; mbi 5000 qytetarë kanë kontaktuar me këto shërbime (kryesisht me ankesa të ngjashme si në vende të tjera). Studimi i të dhënave relevante gjatë shfrytëzimit të këtyre shërbimeve dëshmoi se 37.2% e klientëve kanë përjetuar stres, 40.2% ankth, 15.2% simptoma depresive, 14% probleme familjare, 12% probleme bashkëshortore, 13% probleme financiare dhe 8% e tyre ndjenin nevojë për informata shtesë përkitazi me Covid 19.

Në Kosovë, poashtu, me qëllim të studimit të nivelit të depresionit, një hulumtim i organizuar online gjatë muajve mars dhe prill 2020, me pyetësin PHQ-9 të plotësuar nga 198 persona të moshave nga 16-64 vjeç (mosha mesatare 27.04 vjeç), dëshmoi se 65.2 % e tyre kanë deklaruar se si pasojë e Pandemisë Covid-19 iu ka përkeqësuar gjendja e tyre psikologjike, përderisa 42.4 % e personave kanë rezultuar se kanë një formë të çrregullimit depresiv nga i lehtë deri tek i rëndë. Këto indikojnë nevojën e adresimit me kohë të problematikës së shëndetit mendor në popullatë (Fanaj, N. etj, 2020; pa publikuar).

Studimi tjetër i realizuar në Maj 2020 në Kosovë (Shahini, M 2020; pa publikuar) me qëllim të hulumtimit të ndikimit të izolimit social në shëndetin mendor të studentëve në kohë pandemie ku janë përfshirë 215 pjesëmarrës të moshave 18 deri në 45 vjeç, kanë raportuar që izolimi social ka ndikuar negativisht në mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, ku 32.7% e tyre janë ndjerë shumë të vetmuar. Pjesëmarrësit me shkallë të lartë të izolimit social dhe vetmisë kishin më shumë probleme me ankth, depresion si dhe probleme në sjellje gjatë izolimit për shkak të pandemisë krahasuar me ata që nuk kishin ndjenja të tilla. Interesante në këtë studim është që pjesëmarrësit të cilët kanë qenë gjithmonë në kërkim të informatave dhe shpjegimeve mbi virusin kanë raportuar më pak probleme emocionale dhe të sjelljes krahasuar me ata të cilët nuk kanë qenë insistues në kërkime të tilla.

Nga studimet e bëra përfundohet se edhe studentët raportojnë jetë më pasive, më shumë ankth dhe më shumë simptoma të depresionit. Si probleme më të shpeshta klinike janë paraqitur stresi, ankthi, çrregullimi i stresit posttraumatik tek personat që kanë humbur të afërmit, fobitë, obsesionet, depresionet dhe epizodat psikotike.

Shoqëria dhe institucionet si në nivel komunal gjithashtu edhe në atë qendror, si gjatë pandemisë por dhe më parë, janë ballafaquar me raste të rënda të personave me çrregullime të rënda psikiatrike të cilët ose nuk kanë përkujdesje të afërt familjare ose familjet heqin dorë për kujdes nga pamundësia sociale dhe rrethanat e ndryshme jetësore që kanë.

Nga hulumtimet e mësipërme por dhe nga raportimi i profesionistëve të shëndetit mendor në institucionet ku ofrohen shërbimet e tilla, që nga fillimi i pandemisë dhe deri më tani (edhe pse tani në forma më adaptive karshi situatës), mund të përfundohet se ekziston rritja e numrit të qytetarëve që kanë nevojë për shërbime psikologjike dhe psikiatrike.

Që nga fillimi i Pandemisë Covid 19 me paraqitjen e rasteve të para, shërbimet e shëndetit mendor në gjitha nivelet janë ofruar duke i adaptuar shërbimet konform situatës, si ruajtja e vazhdimësisë terapeutike të personave me çrregullime të rënda të shëndetit mendor, ofrimi i kujdesit në kriza (akute) në njësitë përkatëse psikiatrike spitalore në SHSKUK, përkujdesja komunitare si dhënia e depo terapisë dhe kujdesi shtëpiak në familje të klientëve përmes ekipeve mobile të Qendrave të Shëndetit Mendor në Bashkësi (QSHM), këshillimet me klientë dhe ndihma e parë psikologjike përmes linjave telefonike nga MSh dhe Departamenti i Psikologjisë i Universitetit Hasan Prishtina (Departamenti i Psikologjisë i UP), si dhe të gjitha njësitë përkatëse të SHSKUK, përkujdesja afatgjatë / rezidenciale e klientëve me çrregullime të rënda të shëndetit mendor në Shtëpitë për Integrim në Bashkësi (SHIB) dhe Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), si dhe qëndrueshmëria e programit të terapisë mbajtëse me metadon.

4.1. Kapacitetet institucionale dhe njerëzore

Duke ju referuar Ligjit për Shëndetësi Nr 05/L-125, Ligjit për Shëndet Mendor Nr 05/L-025, shërbimet e shëndetit mendor janë të organizuara në tri nivelet e kujdesit shëndetësor me përgjegjësitë përcaktuara sipas niveleve të organizimit të sistemit shëndetësor. Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) është përgjegjës për identifikimin, referimin dhe përcjelljen e klientëve me çrregullime mendore dhe është i organizuar në nivel lokal, përderisa niveli dytësor dhe tretësor është i organizuar në kuadër të SHSKUK dhe është përgjegjës për diagnostikimin, trajtimin, rehabilitimin dhe risocializimin e klientëve me çrregullime të shëndetit mendor.

Kujdesi Dytësor Shëndetësor ofron shërbimet e shëndetit mendor nëpërmjet QSHM dhe SHIB, dhe Departamenteve Psikiatrike (DP) në kuadër të Spitaleve të Përgjithshme (SP) dhe QIRSKP në Shtime.

Kujdesi tretësor shëndetësor për shëndet mendor ofrohet në Klinikën e Psikiatrisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) e cila ofron edhe shërbime dytësore për regionet Prishtinë, Mitrovicë dhe Ferizaj, në mungesë të Departamenteve psikiatrike në spitalet respektive.

Mangësi e evidente paraqet fakti se në Fakultetin e Mjekësisë të UP ende nuk është themeluar si e veçantë Katedra e Psikiatrisë që do të paraqiste bazë të domosdoshme mësimore, hulumtuese e

shkencore për ngritjen e kapaciteteve profesionale të profesionistëve të diplomuar shëndetësorë dhe studimin meritore të problematikës klinike të shëndetit mendor në situatën e Pandemisë aktuale dhe situatave të ngjashme në të ardhmen.

4.1.1. Institucionet e shëndetit mendor me bazë komunitare

Shërbimi komunitar dhe rezidencial ofrohet përmes Shërbimit profesional të shëndetit mendor që është pjesë organizative dhe funksionale e SHSKUK - rrjetit të nëntë (9) QSHM me nëntë (9) SHIB që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor në zonat përfshirëse regjionale si në vijim: Regjioni Prishtinë - QSHM Prishtinë dhe QSHM Podujevë me dy (2) SHIB në Fushë Kosovë (1) dhe Drenas (1), Regjioni Mitrovicë - QSHM në Mitrovicë dhe Skenderaj dhe me dy (2) SHIB, Regjioni Prizren - QSHM me SHIB, Regjioni Pejë - QSHM me SHIB, Regjioni Ferizaj - QSHM me SHIB, Regjioni Gjakovë - QSHM me SHIB, Regjioni Gjilan - QSHM dhe SHIB, dhe QIRSKP në Shtime si institucion i veçantë psikiatrik me shtretër për kujdes dhe trajtim afatgjatë rezidencial për klientët me çrregullime të rënda mendore.

4.1.2. Kapacitetet në Spitale të përgjithshme

Në kuadër të shtatë (7) Spitaleve të përgjithshme në Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë funksionojnë katër (4) Departamente Psikiatrike.

4.1.3. Kapacitetet në QKUK

Kujdesi tretësor shëndetësor për shëndet mendor ofrohet në QKUK në Klinikën e Psikiatrisë e cila përbëhet nga Repartet e Klinikës së Psikiatrisë, Njësia e Kujdesit Intenziv Psikiatrik, Njësia për Sëmundjet e Vartësisë dhe Qendra për Shëndet Mendor për Fëmijë dhe Adoleshent (QSHMFJA).

4.1.4. Shtretërit psikiatrik

Në nivel vendi janë 307 shtretër (1/6.000 banorë) për diagnostikim, trajtim, rehabilitim dhe risocializim të të sëmurëve psikiatrik. Për diagnostikim dhe trajtim të rasteve akute psikiatrike në QKUK dhe Departamentet psikiatrike në SP janë në dispozicion 152 shtretër, ndërsa 155 shtretër janë në dispozicion për trajtim afatgjatë psikiatrik (kryesisht rastet më të rënda psikiatrike dhe pa mbështetje familjare, në kuadër të SHIB dhe QIRSKP në Shtime; numri i shtretërve për trajtim akut dhe për trajtim afatgjatë psikiatrik është 1/12.000 banorë. Proporcioni psikiatër/shtrat është 1:6, infermier/shtrat 1:2 në njësitë me shtretër, përderisa infermier/komunitet 1:28.000 banorë.

4.1.5. Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

Është institucion i veçantë për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për persona me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale. Ka kapacitet prej 36 shtretërve me personel prej 7 psikiatërve (dy prej tyre psikiatër forenzik), 23 infermiereve, 2 psikologëve klinik dhe 2 punëtorëve social.

4.1.6. Burimet njerëzore

Sa i përket burimeve njerëzore, në nivel vendi në institucionet publike shëndetësore janë të punësuar 52 psikiatër (1/33 mijë banorë) prej të cilëve 45 psikiatër për të rritur dhe 7 (shtatë) për fëmijë dhe adoleshent, 217 infermier (1/8.300 banorë), 10 specialist të psikologjisë klinike, 2 psikolog klinik (1/150.000 banorë), 7 punëtorë social dhe 2 këshilltarë psikosocial, që zhvillojnë veprimtarinë në nivelin dytësor dhe tretësor shëndetësor, (popullata e Kosovës 1.8 mil. banorë ASK Statistikat e Popullsisë 2018). Në kuadër të sektorit privat të shërbimeve shëndetësore, ekziston një numër i konsiderueshëm i shërbimeve psikiatrike dhe psikologjike.

4.2. Shërbimet e ofruara gjatë pandemisë Covid 19

Institucionet e shëndetit mendor në SHSKUK që me paraqitjen e rastit të parë me infeksionin SARS Cov 2, kanë ofruar shërbime konform rekomandimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, IKSHIP, OSH, ECDC, CDC si dhe rekomandimeve ditore të marra nga Komiteti për menaxhimin e pandemisë Covid-19 në SHSKUK, me kapacitetet ekzistuese infrastrukturore dhe njerëzore në dispozicion.

Kujdesi dhe trajtimi i klientëve ka vazhduar me sigurimin e vazhdimësisë terapeutike përmes dhënies së depo preparateve për klientët nën përkujdesje të QSHM si në institucion poashtu dhe në rastet e krizës dhe pamundësisë së familjeve për lëvizje përmes ekupeve mobile të QSHM. Si rrjedhojë e situatës me panedeminë e Covid 19, sipas rekomandimeve të institucioneve relevante janë pezulluar aktivitetet e qëndrimit ditor në QSHM si dhe seancat grupore terapeutike, rehabilituese dhe risocializuese, ndërkaq këta klientë në baza të rregullta janë këshilluar dhe përcjellur përmes konsultave telefonike.

Për shfrytëzuesit e shërbimeve të cilët nuk kanë qenë klientë nën përcjellje, janë ofruar shërbime përmes platformave elektronike dhe linjave telefonike të MSh dhe Departamentit të Psikologjisë të UP, si dhe institucioneve të Shërbimit profesional të shëndetit mendor, por dhe nga psikiatrit dhe psikologët në telefonat e tyre personal. Pacientët të cilët kanë pas përkeqësime dhe krizë janë referuar dhe kanë marrë shërbime në Klinikën e Psikiatrisë dhe Departamentet Psikiatrike të SP, përmes linjave telefonike në dispozicion për ofrim të shërbimeve.

4.2.1. Kujdesi afatgjatë psikiatrik rezidencial

SHIB dhe QIRSKP në Shtime kanë vazhduar me kujdes të shtuar trajtimin e rezidentëve me çrregullime të rënda mendore dhe deri më sot nuk është prekur (në bazë të raportimeve) asnjë klient me infeksionin COVID 19 të raportuar deri me sot.

4.2.2. Shërbimi psikiatrik në Qendrën Studentore Karantinë

Specialistët psikiatër nga Klinika e Psikiatrisë kanë ofruar shërbime psikiatrike në Qendrën Studentore Karantinë QSK), nga data 9 maj e deri në mbyllje të QSK poashtu specialistet psikiater nga QSHM dhe QIRSKP në Shtime në mënyrë rotative poashtu kanë ofruar kujdestari në QSK dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës nën koordinimin e Qendrës Operative të Emergjencës të MSh.

4.2.3. Instituti i Psikiatrisë Forenzike

Ky Institucion ka ofruar dhe ofron shërbimet e përcaktuara dhe gjatë kësaj periudhe ka pasur 23 pranime të rasteve të reja të klientëve me çrregullime të shëndetit mendor që kanë rënë në konflikt me ligjin.

4.2.4. Abuzimi me substanca psikoaktive

Referuar raportimit të rregullt mujor të Qendrave zbatuese të Programit të terapisë mbajtëse me Metadon, Programi nuk është ndërprerë përkundrazi është vërejtë një rritje e lehtë e numrit të klientëve që janë kyçur në Program dhe kanë marrë shërbime në Qendrat për metadon.

4.2.5. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë kohës së pandemisë MSh ka funksionalizuar platformën e shërbimeve telefonike me Departamentin e Psikologjisë të UP për ofrimin e ndihmës së parë psikologjike për qytetarët e vendit përmes ofrimit të këshillave online për të gjithë qytetarët në nevojë. Deri më 1 Qershor 2020 mbi 5000 qytetarë kanë shfrytëzuar shërbimet e kësaj linje telefonike.

4.2.6. Departamenti i Psikologjisë i Universitetit Hasan Prishtina

Përveç bashkëpunimit të sipërmendur me MSh në themelimin dhe funksionalizimin e linjës mbështetëse psikologjike on-line, Departamenti i Psikologjisë i UP ka dizajnuar dhe ka vënë në shfrytëzim të popullatës së gjërë, dy video psiko-edukuese për teknikat e relaksimit neuromuskular në rrethanat e stresit dhe të ankthit. Departamenti i Psikologjisë i UP poashtu është duke realizuar aktivitete të përbashkëta hulumtuese me Klinikën e Psikiatrisë të QKUK.

5.1. Përfundim

Studimet e realizuara në Kosovë gjatë kohës së pandemisë, konfirmojnë rritje të nivelit të stresit, ankthit dhe depresionit si rezultat i pandemisë posaçërisht për shkak të ndryshimeve të mëdha në mënyrën e jetesës, krizës ekonomike, kufizimeve të ndryshme, presionit nga mësimi online, frika nga infektimi etj. Nga studimet e bëra përfundohet se edhe studentët raportojnë jetë më pasive, më shumë ankth dhe më shumë simptoma të depresionit. Si probleme më të shpeshta klinike janë paraqitur stresi, ankthi, çrregullimi i stresit posttraumatik tek personat që kanë humbur të afërmit, fobitë, obsesionet, depresionet dhe epizodat psikotike.

Njëkohësisht, duhet theksuar se një nga problemet kryesore në vendin tonë është stigma nga sëmundjet psikiatrike dhe infeksioni me Covid 19 si dhe mungesa e informatave përkitazi me këto probleme. Përvoja nga studimi paraprak i Departamentit të Psikologjisë të UP është se personat me probleme më të theksuara të shëndetit mendor kanë përfituar nga video të thjeshta informuese në gjuhën shqipe për problemet e stresit, ankthit dhe depresionit.

Krahasuar me standardet ndërkombëtare, mund të konsiderohet se Kosova ka kapacitete infrastrukturore të shëndetit mendor në aspektin e shtretërve akut psikiatrik, shtretërve për trajtim afatgjatë/rezidencial dhe shërbimeve komunitare përmes QSHM, që në bashkëpunim me KPSH të ofrojnë shërbimet e shëndetit mendor të qasshme dhe në kohë duke respektuar të drejtat e njeriut e veçanërisht të drejtat e klientëve me çrregullime të shëndetit mendor përmes arritjes së objektivave dhe realizimit të aktiviteteve të përshkruara në Planin e veprimit. Në këtë aspekt, theksi duhet të vëhet poashtu në ngritjen e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve shëndetësorë, si dhe mobilizimin e të gjitha resurseve në dispozicion në rrafshin e shëndetit mendor jashtë institucioneve shëndetësore me theks të veçantë në fushën e psikologjisë klinike. Njëkohësisht, duhet të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve për personat me çrregullime akute dhe kronike mendore si dhe të punohet në mënyrë sistematike në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve përkitazi me faktorët e rrezikut dhe masat parandaluse që duhet ndërmarrë me qëllim të ruajtjes së shëndetit mendor të tyre në rrethanat e Pandemisë globale.

5. OBJEKTIVA E PERGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE PLANIT

Objektiva e përgjithshme

Ruajtja e shëndetit mendor të popullatës gjatë dhe pas Pandemisë Covid 19

Objektiva specifike 1

Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e shëndetit mendor dhe për faktorët e rrezikut gjatë dhe pas pandemisë Covid 19

Aktivitetet

- 1.1. Mbajtja e vebinareve
- 1.2. Krijimi i uebfaqes për institucionet e shëndetit mendor
- 1.3. Realizimi i video mesazheve për ofrimin e shërbimeve, kundër stigmës, ankthit, depresionit, drogave, vetëlëndimeve dhe sjelljes autoagresive.
- 1.4. Hartimi dhe botimi i fletushkave, fletëpalosjeve dhe posterëve tematik për informimin për ankthin, depresionin, stresin, sjelljen vetëlënduese, dhe të drejtat e pacientëve.
- 1.5. Pjesëmarrja e ekspertëve autoritativ të vendit në lëminë e shëndetit mendor në media elektronike, TV, Radio nacionale e lokale për promovimin e shëndetit mendor në kohën e Pandemisë, parandalimin dhe identifikimin e hershëm të çrregullimeve mendore e psikosomatike. si dhe mundësitë e trajtimit adekuat.
- 1.6. Organizimi i tryezave me institucionet lokale në kuadër të senzibilizimit të shëndetit mendor
- 1.7. Organizimi i tryezës 'Varësia ndaj drogave dhe Covid 19'

Objektiva specifike 2

Sigurimi i shërbimeve psikologjike online për qytetarët dhe profesionistët e angazhuar në ballafaqimin me Pandeminë Covid 19

Aktivitetet

- 2.1. Funkcionalizimi i shërbimeve on line të mbështetjes psikosociale përmes platformave të ndryshme elektronike, në nivelin qendror (IKSHIP, MSh) dhe rajonal (QSHM).
- 2.2. Intervenimet online përkitazi me sjelljet vetë-lënduese veçanërisht për adoleshentë.
- 2.3. Shërbime këshilluese online për të varurit nga droga dhe alkooli.
- 2.4. Zgjerimi i platformës vetmenaxhuese online 'I fight Depression' në institucionet e shëndetit mendor në vend.

- 2.5. Trajnimi i stafit për shërbime online për fëmijë dhe adoleshentë.
- 2.6. Trajnimi i psikologëve, psikologëve klinik të licencuar dhe vullnetarve për aplikimin e aplikacion.
- 2.7. Mbikqyrja profesionale e vullnetarëve për përkrahje psikologjike.

Objektiva specifike 3

Rritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve për shëndet mendor, përmes i instrumenteve elektronike gjatë dhe pas Pandemisë Covid 19

Aktivitetet

- 3.1. Zhvillimi i aplikacioneve (app) për shëndet mendor në gjuhën amtare.
- 3.2. Zhvillimi i shërbimeve nëpërmjet telefonit apo kontaktit me aplikacione të tjera në QSHM në rajone, për rastet klinike që kërkojnë angazhim më sistematik të resurseve të shëndetit mendor në dispozicion.
- 3.3. Ofrimi i shërbimeve me telefon apo me chat gjatë shfrytëzimit të këtyre shërbimeve.
- 3.4. Trajnimi i stafit në shërbimet e shëndetit mendor për shërbime online.

Objektiva specifike 4

Fuqizimi i shërbimeve të kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor gjatë dhe pas Pandemisë Covid 19

Aktivitetet

- 4.1. Sigurimi i vazhdimësisë terapeutike të klientëve në gjendje remisioni.
- 4.2. Sigurimi i vazhdimësisë terapeutike dhe trajtimi në institucionet afatgjata rezidenciale për të sëmurët kronik psikiatrik.
- 4.3. Mbështetja profesionale e institucioneve të shërbimit korrektues, burgjeve, dhe institucioneve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në trajtimin e klientëve me çrregullime të shëndetit mendor në raste të shfaqjes së nevojës.
- 4.4. Mbajtja e vazhdimësisë terapeutike për personat në programin e terapisë mbajtëse me metadon.
- 4.5. Rekrutimi i stafit profesional në QSHM dhe Klinikën e Psikiatrisë e Departamentet psikiatrike të SP. Punësimi i dhjetë (10) specialistëve të psikologjisë klinike në institucionet publike të shëndetit mendor.
- 4.6. Furnizimi i institucioneve të shëndetit mendor me shtretër dhe komunitar me barna dhe materiale mbrojtëse nga LE e MSH me theks te vecante barnat me veprim afatëgjatë për personat me çrregullime të rënda të shëndetit mendor

Objektiva specifike 5

Ofrimi i shërbimeve psikosociale sipas praktikës më të mirë mjekësore

Aktiviteti

- 5.1. Hartimi i udhëzuesit (PSO) për veprim në raste të paraqitjes së rasteve me COVID 19 në institucionet rezidenciale.
- 5.2. Hartimi i udhëzuesit klinik për çrregullimet e shëndetit mendor
Hartimi i udhëzuesit për trajtim dhe menaxhim të stresit, ankthit, depresionit, dhunës në familje, drogës, alkoolit, vetëlëndimeve dhe tentimet e vetëvrasjeve e vetëvrasjet.
- 5.3. Hartimi i udhëzuesit (PSO) për shërbime psikosociale përfëmijë dhe adoleshentë

Objektiva specifike 6

Sigurimi i të dhënave të bazuara në dëshmi për gjendjen e shëndetit mendor gjatë dhe pas pandemisë Covid 19

Aktiviteti

- 6.1 Zhvillimi i bashkëpunimit të përbashkët hulumtues - shkencor me Departamentin e Psikologjisë të UP.
